

20151534374

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR INSPEKSION FINANCIAR NË**  
**SEKTORIN PUBLIK**

Neni 1

Në Ligjin për inspeksion financiar në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13 dhe 43/14) në nenin 7 paragrafi (2) fjalët: "në sferën e financave dhe revizionit të brendshëm dhe të jashtëm" zëvendësohen me fjalët: "në sferën e financave apo revizionit të brendshëm apo të jashtëm".

Neni 2

Në nenin 23 paragrafi (1) fjalët: prej 5.000 deri më 7.000 euro" zëvendësohen me fjalët: "prej 500 deri më 1.000 euro".

Neni 3

Në nenin 24 paragrafi (2) pas fjalëve: "procedura për barazim" shtohet presje dhe fjalët: "lëshohet urdhërpagesë e kundërvajtjes."

Pas paragrafit (2) shtohen pesë paragrafë të rinj (3), (4), (5), (6) dhe (7) si vijojnë:

"(3) Nëse inspektori kompetent përcakton kundërvajtje detyrohet kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë të kundërvajtjes.

(4) Personat e autorizuar zyrtarë detyrohen të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e kundërvajtjes të lëshuara dhe për rezultatit e procedurave të ngritura.

(5) Në evidencën nga paragrafi (1) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës së kundërvajtjes që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(6) Të dhënat personale nga paragrafi (2) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(7) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes e përcakton ministri i Financave."

Neni 4

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".